



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Institucioni Komunal Publik Shtëpi për persona të moshuar Kiro Krsteski Pllatnik – Prilep.

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së shpenzimeve të buxhetit të dotacioneve (903) për vitin 2021.

### Qëllimi i revizionit:

Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Shtëpia funksionon me numër të pamjaftueshëm të kuadrit profesionist për kryerjen normale, cilësore dhe në kohë të shërbimeve dhe kujdesit të nevojshëm për të moshuarit, veçanërisht gerent-amvise, higjieniste dhe kameriere.
- kontrole të pa vendosura për proceset dhe kushtet e punës të cilët kanë të bëjnë me pritjen dhe lëshimin e produkteve ushqimore.

### Rekomandimet kyçe:

- Rishqyrtimi i dispozitave të aktit për sistematizim të vendeve të punës dhe përshtatjen e numrit të nevojshëm të punonjësve në Shtëpi në pajtim me nevojat reale dhe përmasat e veprimtarisë e cila kryet;
- Vazhdimi i aktiviteteve për punësimin e kuadrit të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë.

### Mendimi i dhënë/konkluzioni \*:



Mendim pa rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim me rezervë për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante.

### Theksimi i çështjes për vazhdimësi dhe pasiguri:

- gjendja e keqe e hapësirave në të cilat janë akomoduar përdoruesi, për mirëmbajtjen e të cilës nuk janë planifikuar mjete me programet vjetor për financim;
- shumica e zvogëluar e bllok dotacioneve në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 edhe për kundër asaj që është rritur numri i përdoruesve.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

- lloji dhe numri i vendeve të punës për kuadrit profesionistë në Rregulloren për normativat dhe standardet nuk korrespondon me nevojat reale;
- nuk është lidhur protokoll ndërmjet ministrive kompetente.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 22 – 124/11 nga 05.12.2022.

\* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbajtur